



### *VENDIM*

*Nr. 43 Datë 13.05.2014*

### **PËR**

## **MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 13.05.2014, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me një ndryshim në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.06.2008, të ndryshuar,

### **Vendosi:**

1. Pika 1 e Vendimit nr. 147, datë 24.12.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE, ndryshohet si më poshtë:  
*Vendimi nr. 93, datë 16.07.2012, do të shtrijë efektet deri në datën 31.12.2014.*
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.